

## THIRRJE PËR OFERTË

### Për përkthim

Programi për të drejtat e njeriut, "HUMAN RIGHTIVISM", i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), ka për qëllim që nëpërmjet shoqërisë civile të përmirësoj të drejtat e njeriut, që janë të natyrshme, origjinale dhe të bazuara në interes të grupit, përmes këtyre tri komponentëve: 1) Të drejtat e njeriut dhe aktivizmi arsimor; 2) Dokumentimi; monitorimi (ëatchdog) dhe qasja strategjike dhe 3) Të drejtat mjedisore.

EC Ma Ndryshe është njëra nga organizatat përfituese të këtij programi, në kuadër të të cilit shpallë këtë thirrje përmes së cilës fton kompanitë/konsorciumet e interesuara të dorëzojnë ofertat e tyre për përkthim.

Dokumenti duhet të përkthehet dhe përshtatet nga gjuha Angleze në gjuhën Shqipe. Tematikë e dokumentit është mjedisi, ku përshkruhet procesi dhe mënyrat për krijimin dhe rritjen e hapësirave gjelbëruesë në vendet publike, dhe menaxhimi i duhur nga institucionet e nivelit lokal dhe qendror.

**Afati për përkthim të dokumentit është data 9 Qershor 2020.**

### Kriteret për ofertim:

Oferta duhet të përmbajë dokumentet në vijim:

- Çertifikata e regjistrimit të biznesit; Çertifikata e numrit fiskal; Çertifikata e TVSH-së (kompanitë që janë deklaruese të TVSH-së),
- Oferta duhet të jetë për faqe (A4) ose për fjalë;
- Pala ofertuese (kompania/konsorciumet) duhet të caktojë një person për kontakt direkt dhe komunikim me EC Ma Ndryshe.

Ofertat duhet të dorëzohen në mënyrë elektronike në [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org) deri më datë 29.05.2020, ora 15:00 me shënimin: "Ofertë për përkthim" ose fizikisht në zyret e EC Ma Ndryshe, Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren. Ofertat që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbajnë dokumentet e kërkuara, nuk do të konsiderohen.

Pas vlerësimit fillestarë të ofertave, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente (dëshmi) shtesë nëse këtë e vlerëson të nevojshme. EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare.

Vetëm kompanitë/konsorciumet fituese do të informohen/kontaktohen. Për më shumë informacione rreth kësaj thirrje për aplikim vizitoni [www.ecmandryshe.org/konkurse](http://www.ecmandryshe.org/konkurse).